



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e III-të

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion;

Mbledhja nr. 12 / 2008;
më 27.05.2008, në ora 10:00;
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225;

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Fatmir Rexhepi, Sala Berisha – Shala, Haki Shatri dhe Berim Ramosaj;

Munguan: Et'hem Çeku, Slobodan Petroviq, Zef Morina, Safete Hadergjonaj, Műfera Şinik dhe Kaqusha Jashari;

Përcjellës prezent: Hakif Jashari e Krenare Sfishta nga MTI (Departamenti Ligjor në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë) dhe Blerina Uka nga NDI.

Nga zyra mbështetëse: Hasan Tahiri, Armend Ademaj dhe Besim Haliti;

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani – Kryetare e Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara nga deputetja Sala Berisha – Shala, lidhur më Projektligjin për plotësim ndryshim te Ligjit për mbeshtetje të ndermarrjeve të vogla dhe të mesme;
4. Të ndryshme;

I. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

III. Shqyrtimi i amendamenteve të propozuara nga deputetja Sala Berisha – Shala, lidhur më Projektligjin për plotësim dryshimin e Ligjit për mbeshtetje të ndermarrjeve të vogla dhe të mesme;

Kryetarja – informoi të pranishmit se Sala Berisha – Shala, deputete, ka paraqitur më 15.05.2008 amendamente lidhur më Projektligjin për plotësim e ndryshim të Ligjit për mbeshtetje të ndermarrjeve të vogla dhe të mesme në zyrën e Kuvendit për parashtrës dhe ankesa.

Sala Berisha – Shala –foli për arsyeshmerinë dhe rëndësinë e këtyre amendamenteve sipas radhës.

Amendamenti 1

Përkufizimi “Ndërmarrje” nga Ligji në fuqi, ndryshohet si vijon:

“Ndërmarrje”- nënkupton ndërmarrjen mikro, të vogël apo të mesme.”

Arsyetim : Rregullorja 2001/6 nuk e trajton nocionin, kriteret, elementet e ndërmarrjes por sanksionon fushën e afarizmit të shoqërisë tregtare.

Për ligjin për mbështetje të NVM-ve kërkohet të definohet se çka nënkuptojmë me nocionin ndërmarrje e kursesi se çka është ndërmarrja.

Anëtarët u pajtuan një zëri me këtë amendament nga fakti se përkufizimi i “ndërmarrjes” është kërkesë standardizimi.

Amendamenti 2

Neni 7 fjalët : “si zonë e veqanarishtë të varfur” të zëvendsohen me tekstin në vijim:

...sipas prioritetit në vijim:

- a) zonë e varfur e një komune të pa zhvilluar ekonomikisht;
- b) zonë e varfur pavarësisht nivelit të zhvillimit ekonomik të komunës.

Komisioni e debatoi këtë amendament dhe sipas anëtarit Berim Ramosaj dhe Haki Shatrit me të cilët u pajtuan edhe anëtarët tjerë, është shumë më e arsyeshme që ky amendament lidhur me nenin 7 të jetë si vijon:

Neni 7 i Ligjit në fuqi:

Fjalët: “të konsiderueshme” zëvendësohen me tekstin në vijim: “mbi 50% të pjesëmarrjes së femrave”

si dhe fjalët:

“si zonë veçanërisht të varfër” zëvendësohen me fjalët në vijim: “komunë e pa zhvilluar ekonomikisht”.

Komisioni u pajtua nje zërit me këtë korigjim.

Amendamenti 3

Neni 6 paragrafi 13. A. 1 i P. ligjit ndryshohet si vijon:

Këshillin e agjencisë për mbështetje të MNVM-ve mund ta themeloj qeveria në bazë të propozimit të Ministrisë të shoqëruar me arsyetimin e agjencisë.

Pas debatit, Komisioni u pajtua që fjalën “mund ta” nga ky amendament të hiqet duke kërkuar që dispozita të riharohet nga pasivja në aktive.

Amendamenti 4

Neni 7 paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

7.2 Për shkak të shkeljes së dispozitave të këtij Ligji përveç paragrafit 7.1, ndërmarrjes i shqiptohet masa e diskualifikimit për pjesëmarrje në çfarëdo programi apo initiative për mbështetje të NMVM-ve për një përdhë dyvjeçare.

Arsyetim:

Me këtë paragraf hiqet mundësia e shqiptimit të masave të dyfishta ndëshkuese pra sipas paragrafit 7.1 dhe 7.2.

Komisioni u pajtua me këtë amendament sepse si u tha është e pa arsyeshme që shkelësi sipas dispozitës 7.1 të ndëshkohet edhe sipas paragrafit 7.2, pra me dy masa ndëshkuese.

Përfundim:

Komisioni i miratoi amendamentet me votë unanime dhe vendosi që këto amendamente të jenë pjesë e raportit të më parshëm.

Në vazhdim kryetarja ua përkujtoj të pranishmëve se sipas informtës së Safete Hadërgjonaj anëtare e komisionit në mbledhjen e kaluar të komisionit me 23.05.08, Raporti i dt.15.04.08 i dorëzuar me 23.04.08 për Komisionin e Buxhetit ende nuk është shqyrtua sipas kompetencës, (sipas iniciativës së saj) nga se në raport janë ndryshuar dhe përfshirë edhe disa amendamente (që i ka vreytuar ajo) e që nuk janë trajtuar në komision.

Ajo ua përkujtoj të parrishmëve se në mbledhjen e dt. 15.04.2008 nga Komisioni është autorizuar Zyra mbështetëse e Komisionit që në bashkëpunim me përfaqësuesit e zyrës ligjore të MTI-së (sponzoruese) të harmonizoi amendamentet sipas kërkesve të standardizimit si dhe për “Këshillin e agjencionit “ të përcaktohet fushëveprimtaria dhe

kryesimi i tij si dhe dispozitat ndëshkimore të plotësohen me dispozita që përcaktojnë autoritetin kompetent për shqyrtimin e masave ndëshkimore dhe procedurat ankimore.

Përfundim:

Komisioni u pajtua me këtë përfundim dhe raportin e dt 15.04.08 e konfirmoi të miratuar duke kërkuar që amendamentet (S.Berisha-Shala) e miratuara në këtë mbledhje të inkorporohen duke i përshtatur teknikisht dhe juridikisht me raportin ekzistues i cili duhet të procedohet sipas rregullave të Rregullores së Punës së Kuvendit.

III – Të ndryshme;

Kryetarja – i njoftoi anëtarët e Komisionit që kanë ardhur në adresë të Komisionit tri kërkesa, si në vijim:

1. Kërkesa e Komunës së Kastriotit (ish Obiliqit) për takim të përbashkët për shqyrtimin e problemeve që ka kjo komunë me KEK-un;
2. Kërkesa e një Grupi punëtorësh të IGK”BALLKAN” të Therandës (ish Suhareka) dhe të Sindikatës së punëtorëve të
3. Kompanisë Hoteliere Turistike “KOSOVA”, që shprehin paknaqësi me mos përmbushjen e obligimeve që dalin nga kontrata e privatizimit me metoden e “Spinofcit special”.

Pas diskutimit të të gjithë anëtarëve për të tri kërkesat e parashtuara

(I- Kërkesa e Komunës së Kastriotit

(I- Kërkesa e Punëtorëve të Kompanisë Hoteliere Turistike “Kosova“

II- Kërkesa e punëtorëve të IGK-“ Ballkan” të

Komisioni përfundoi me rekomandim:

- I- I rekomandohet MEM-it që të ndërmerr nismën për organizimin e një takimi të përbashkët në të cilën do të ftohen përfaqësues të Komunës së Kastriotit, të KEK-ut të MEM-it, të MMPH dhe të Komisionit parlamentar për ETIETT për shqyrtimin e kërkesës si është emërtuar:
“Problemet në relacionin Komunë (Komunë e Kastriotit) -KEK (mos pagesa e taksave për eksploatim, taksave ambientale, degradimi i ambientit....)”
- Kërkesat tjera: (mos përfshirja e organit komunal në Bordin e KEK-ut dhe mos përfshirja e komunës në Komitetin drejtues të Projektit “Kosova C”)
Komisioni i vlerësoi si kërkesa që nuk bien nënë autoritetin e fushë veprimtarisë së Komisionit parlamentar për ETIETT.

- II- I rekomandohet Bordit të AKM-së që kërkesat dhe të drejtat e punëtorëve të Kompanisë Hoteliere Turistike “Kosova” si dhe të IGK”BALLKAN” të

Therandës (ish Suhareka) mundësisht t'i zgjidhi sa ma parë në pajtim me aktet përkatëse si dhe AKM-ja t'i informojë punëtorët për natyrën e pengesave për mos përmbushjen e obligimeve që pasojnë pas privatizimit të ndërmarrjeve të tyre apo sëpaku për afatin e mundshëm brenda të cilit mund të përmbushen obligimet ligjore për realizimin e të drejtave të tyre.

Gjithashtu Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit se javën e ardhme, do të realizohet një vizitë pune në Aeroportin e Prishtinës, kurse për datën dhe agjendën e vizitës, Komisioni do të njoftohet me kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:15;

Kryetare e Komisionit:

Myzejene Selmani